V E N D I M
Nr.683, datë 13.12.2001

PËR RIORGANIZIMIN E RRJETIT ARKIVOR VENDOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e arkivave shtetërore të qarqeve, mbi bazën e arkivave shtetërore të atyre rretheve, të cilat, me ndarjen e re administrative, janë qendra qarku.

Arkivat shtetërore të qarqeve të jenë në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

2. Arkivat shtetërorë të qarqeve administrojnë, krahas pasurisë së trashëguar, edhe dokumentet e krijuara nga institucionet shtetërore që funksionojnë në qark, si dhe fondet e institucioneve që e pushojnë veprimtarinë për shkak të rindërtimit administrativo-territorial.

3. Riorganizimin e arkivave shtetërore të rretheve, që nuk përfshihen në pikën 1, si degë të arkivave shtetërore të qarqeve, që funksinojnë pranë njësive adminstrativo-territoriale ku ato ndodhen. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave vendos kohën e shuarjes së kësaj veprimtarie.

4. Arkivat shtetërore të rretheve Mirditë, Lushnjë dhe Pogradec mbeten si vendruajtje dokumentesh në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përcakton emërtesën, procedurat dhe radhën e tërheqjes së fondeve me rëndësi historike, kombëtare nga ish-arkivat shtetërorë të rretheve, që mbeten degë të arkivave shtetërore të qarqeve.

6. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta